E mërkurë, 17 maj 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, paraqisni çështjen.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Sot vazhdojmë me pyetjet nga pala Mbrojtëse të Dëshmitarit 4748, është ekipi i Selimit, do të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë pushimin. Pushimi do të jetë 40 minuta dhe jo 30 minuta sepse ka disa probleme teknike për t’u përgatitur për dëshmitarin tjetër, do të takohemi përsëri në 11.40 minuta, atëherë do të fillojmë.

--- Pauza fillon në orën 11.01

--- Seanca rifillon në orën 11.41

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni, ju lutem. Kalojmë në seancë private, ju lutem. Kjo bëhet për të mbrojtur Dëshmitarin.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e ndërpresim punën deri në 14.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.05

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pothuajse kemi përfunduar dëshminë e katër dëshmitarëve të parë. Prita që ky dëshmitar të përfundonte, po jemi aty afër.

Ky Trupi Gjykues është i shqetësuar se të gjitha provat deri tani janë dëgjuar në seancë private apo të mbyllura. U kujtojmë palëve se në bazë të nenit 21, paragrafi 2, të ligjit të akuzuarit kanë të drejtë të dëgjojnë seanca publike dhe të drejta dhe se është interesi i publikut që këto procedura, sa më shumë të jetë e mundur, të zhvillohen në seanca publike.

Trupi Gjykues kujtoj gjithashtu se në paragrafin 1 të Urdhrit vetë për Zhvillimin e Procesit palët dhe pjesëmarrësit

duhet të respektojnë karakterin publik të procesit. Ky Trup Gjykues vendosi që argumentet ligjore dhe paraqitja e provave nga palët dhe pjesëmarrësit të bëhet në seanca të mbyllura apo private vetëm kur është rreptësishtë e nevojshme në përputhje me rregullin 120 të Rregullores.

Për fat të keq, deri tani një pjesë e madhe e këtij gjykimi është bërë në seancë të mbyllur apo private. Nevoja për mbrojtën e dëshmitarëve sigurish, është përligje e masave mbrojtëse të urdhëruara nga Trupi Gjykues, që nga ana tjetër kanë të bëjnë me karakterin publik të procesit. Kjo është e nevojshme për të mbrojtur dëshmitarët.

Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që gjyqi të vazhdojë të jetë publik dhe që Trupi Gjykues të shqetësohet më pak që ai të mos bëhet gjithmonë privat, po të bëhet sa më shumë publik.

Trupi Gjykues, pra, kërkon parashtrime nga palët që të sigurojnë një masë më të madhe publiciteti të këtyre procedurave.

Palët, pra, informojnë që Trupi Gjykues do të shqyrtojë urdhërimin e palëve për të propozuar versione të redaktuara publike të transkripteve në seancë private apo të mbyllura që publiku t'i kuptojë çfarë ndodhë.

Megjithatë, nëse palët, përmes diskutimeve midis palëve, dalin me zgjidhje alternative, Trupi Gjykues do t'i marri parasysh këto propozime për të arritur publicitet më të madh.

Palët, pra, urdhërohen të angazhohen në diskutime *inter partes* për këtë çështje dhe deri në 31 maj 2023 të sigurojnë zgjidhje për të garantuar publicitet më të madh të këtyre procedurave.

Ndërkohë për dëshmitarët e tjerë, palët udhëzojnë që të marrin parasysh parimin e publicitet kur të kërkojnë që palë të dëshmive të dëshmitarëve të dëgjohen në seancë private apo të mbyllura.

Nuk do të kundërshtojmë dhe po e shtoj këtë, që të futemi dhe të dalim në seancë private dhe të mbyllura. Sepse e kuptojmë që është pjesë e procesit në një çështje si kjo.

Ne besojmë që avokatët do të ushtrojnë gjykimin e tyre më të mirë për të organizuar pyetjet në mënyrë që të nxisë publicitetin. Me këtë dua të them, që ta kemi dëshmitarin - dhe këta do ta bëjmë me dëshmitarin e ardhshëm - dhe materialet që janë konfidenciale t'i përcaktojmë që në fillim dhe pastaj të vazhdojmë me seancë publike deri sa të dali diçka që është e nevojshme për t'u mbrojtur.

Gjithashtu mendojmë që avokatët do të kenë kujdes të veçantë të mos nxjerrin informacion konfidencial gjatë seancave publike dhe do t'i formulojnë pyetjet e tyre në mënyrë të tillë që të shmangë ndodhi të tilla.

Dhe këtu përfundon urdhri gojor.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Meqenëse jemi në seancë publike, gjithkush që dëgjojnë mund të krijojnë përshtypje se përgjegjëse për këtë, për faktin që ne kemi ndenjur në seancë

publike që në fillim, është përgjegjëse Mbrojtja.

Dua që ta them, që çdo devijim nga kjo, është rezultat i kërkesës së Prokurorisë që është miratuar nga Trupi Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e dhamë këtë urdhër për të fajësuar njeri.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju mund të mos e keni pasë këtë qëllim. Po meqenëse është një nga gjërat e pakta që publiku mund të shikojë, është formuluar në mënyrë të tillë që duket sikur Mbrojtësit janë në një farë mënyre fajtorë për këtë gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pasur çaste kur dikush ka shkelur rregullat duke përmendur emrat e një dëshmitari apo dëshmitarëve të mbrojtur dhe kjo nuk ka ardhur vetëm nga Prokuroria. Ka pasur shkelje të pafajshme, të paqëllimshme. Unë po flas, mos më ndërpre. Ka pasur shkelje të paqëllimshme dhe ka kanë krijuar problem. Dhe duhet të kemi parasysh që të mos i kemi këto lloj shkelje.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi krijuar probleme të tilla sepse kemi qenë në seancë private. Unë jam i shqetësuar për faktin se përshtypja që mund t'i krijohet publikut nga urdhri që sapo dhatë është sikur ne, Mbrojtja, jemi, në një farë mënyre, pajtuar me këtë situatë që është krijuar për faktin që ky gjyq është zhvilluar në seanca private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, kjo, prandaj që ky urdhër gojor kërkon që të gjeni zgjidhje dhe ta trajtoni në mënyrë të përgjegjshme këtë problem.

Mund ta sillni dëshmitarin tani brenda.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë private, më falni.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

--- Seanca rifillon në orën 15.13

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë publike, në qoftë se nuk jemi.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Në seancë publike jemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Meqë jemi në seancë publike mund të them se mbaruam me dëshmitarin e fundit dhe jemi gati të fillojmë me Dëshmitarin 3165 i thirrur nga Prokuroria.

Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Më jep një çast ju lutem. Kompjuteri nuk po më lejon që të futem. Mund t'ju kërkoj të më jepni dhe në çast sa të hyj në kompjuter që të nxjerr materialet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem.

Po ndërkohë dëshmitari mund të vijë.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ndërkohë që vjen dëshmitari. Sikurse thatë dhe në seancën e fundit, unë do të kërkoja që të merrja të dhënat personale por edhe deklaratën e 154. Një nga çështjet me këtë dëshmitar, sikurse e parashtruam në mocionin për masat mbrojtëse, është [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]

Kështu meqenëse do hyjmë në rrethanat specifike të kësaj deklarate, do të nxirrnim të dhënat identifikuese të dëshmitarit. E kuptoj vendimin e Trupit Gjykues. Unë kam dy fusha që mendoj se nuk do të nxirrnin identitetin. Sigurisht, që ne duam të respektojmë udhëzimin që keni dhënë ju edhe vendimin që nxorët dje ku na këshilluat që t'i rishikojmë të gjitha dëshmitë edhe deri më 1 qershor t'i themi Gjykatësit se çfarë mund të jetë publike dhe jo. Po për shkak se këto hollësitë e dëshmisë [REDAKTUAR] janë kaq të ndërlidhura me ngjarjet dhe me vendin ku ka ndodhur ngjarja dhe me faktin se kush është i afërmi, të gjitha këto aspekte, janë pak shqetësuese dhe kam merak t'i bëjë në seancë publike. Por dy fusha ama të pyetjeve që kam mund t'i bëj në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të diskutojmë më shumë për këtë kur të vijë momenti. Ne mund të fillojmë me seancë publike dhe kalojmë në seancë të mbyllur kur të keni këtë pjesë konkrete. Nëse do ju duhet që të përmendni pjesë të aktgjykimit që përmendët mund të gjeni një

mënyrë ose mund të kalojmë pastaj në seancë të mbyllur kur përmendi ndonjë detaj identifikues.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kuptoj. Pra, do të jemi fillimisht në seancë private pastaj do kalojmë në seancë publike?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Apo do t'i të fillosh në seancë private? Të vij dëshmitari pastaj do kalojmë në seancë private, shkurtimisht.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe një ju lutem. Kini parasysh mikrofonat kur flisni, e kam edhe për veten time këtë. Nuk mund t'i lëmë të ndezur mikrofonat, sepse sidomos aty pjesa juaj është më afër dëshmitarit.

Mirëdita, Dëshmitar. Tani, Asistentja e Gjykatës do ju japi tekstin e deklaratës solemne dhe ju duhet ta lexoni në zbatim të rregullës 141, nënparagrafi 2, i Rregullores së Procedurës dhe Provave. Lexo me zë të lartë tekstin.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm, e ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W03165

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

Dëshmitar. Mund të uleni.

DËSHMITARI: Falemnders.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, sot do fillojmë me dëshminë tuaj, që mendohet se do të zgjasë rreth dy ditë. Sikurse e dini, fillimisht do t'ju bëjë pyetje Prokuroria. Kur të përfundojë ata, kanë palët mbrojtëse të drejtë t'ju bëjë pyetje, si edhe anëtarë të Trupit Gjykues mund të kenë pyetje për ju.

Prokuroria parashikon 2 orë për t'ju bërë pyetje. Mbrojtja parashikon 7 orë. Sa i takon secilit nga vlerësimet kohore që kanë bërë, shpresoj që të gjitha palët të jenë të kujdesshme me orarin. Edhe Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje shtesë sqaruese, nëse përmbushen kushtet.

Dëshmitar, përgjigjuni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk i kupton pyetjen, lirisht kërko që të përsëritet pyetja dhe thoni që s'e kuptoni që ta sqarojë.

Po ashtu, na thoni ku e keni bazën e dijenisë suaj të fakteve dhe rrethanave për të cilat do të duhet të jepni përgjigje.

Në rast se Prokuroria ju thotë të thoni disa nga korrigjimet që keni bërë në deklaratën tuaj, duhet të thoni për procesverbal që deklarata me shkrim është korrigjuar në listën përkatëse të korrigjimeve dhe se kjo reflekton saktësisht deklaratën tuaj.

Ju lutem, flisni afër mikrofonit, prisni pesë sekonda

para se të përgjigje edhe flisni ngadalë që dhe përkthyeset të kenë mundësi t'ju ndjekin.

Gjatë këtyre ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk lejoheni që të diskutoni me asnjë dëshmisë tuaj jashtë kësaj salle apo gjetkë. Nëse dikush ju bën pyetje jashtë kësaj Gjykate për dëshminë tuaj, ju lutem na njoftoni.

Trupi Gjykues e kupton që Prokuroria ka kopje të deklaratave të mëhershme tuajat, që t'i keni parasysh ose t'i keni si referencë gjatë kohës që jepni dëshmi. Nëse nuk ju kujtohet diçka dhe keni nevojë t'i shihni këto dokumente për të rifreskuar kujtesën, njoftoni Trupi Gjykues përpara se të ndodhë kjo. Dhe kjo duhet të bëhet vetëm në qoftë se duhet t'i bëni një referencë diçkaje që s'e mbani mend. Nuk duhet të lexoni dokumentin që ju vihet përpara.

Nëse keni nevojë për pushime, lirisht na njoftoni dhe ne do jua plotësojmë këtë kërkesë.

Prokurorja, do të filloj me pyetjet e saj, por për këtë duhet të kalojmë në seancë private në mënyrë që të mbrojmë të dhënat tuaja personale.

Sekretare e Gjykatës, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

ZNJ. MAYER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, na the se pe disa burra me armë zjarri. Përqendrohu tek kjo. Sa afër ishe kur i pe? Nga sa afër i pe?

PË. Dikund 3-4 metra.

PY. 3-4 metra ishe kur i pe për herë të parë këta burrat?

PË. Jo. Në herë të fundit. Kur i kam pa ishna, kur jam taku me ta dikund 3-4 metra jam takuar.

PY. E fillojmë nga hera e parë që i pe. Sa larg ishe kur i pe për herë të parë?

PË. Për herë të parë janë kanë dikun përmbi 150 metra 200.

PY. Dhe ti qëndrove në vend apo shkove në drejtim të tyre?

PË. Shkova me një rrugë ma trop për me ju dal përpara për me ndal, me ndal rastin.

PY. The që shkove nga një rrugë tjetër. A mund të na e shpjegosh se çdo të thuash ça ishte kjo rruga tjetër?

PË. Po ishe rruga tjetër, se ata që ishin në makinë ishin në një rrugë ma trop për me i dalë përpara makinës, ishte më e afërt. Se ku ishin hyp edhe ku u duke me dalë përpara.

PY. Po pse doje që t'i dilje përpara t'i shifje?

PË. Po doja t'i shihja se i ndjeva krimat dhe i pashë që i kishin marrë të afërmit e mi me një makinë me gjind me maska.

PY. Të përqendrohemi tek veshjet e këtyre njerëzve. A mund t'i tregosh Trupit Gjykues se çfarë kishin veshur këta njerëz?

PË. Po. Këta kanë pasë uniforma të zeza të veshna, në emblema

të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe maska të zeza në fytyrë.

PY. Kur thoni me emblema të UÇK-së, a mund të na e përshkruani çfarë patë tek kjo emblema?

PË. Po rrethit të saj shkrun Ushtria Çlirimtare e Kosovës, UÇK është në kry, domethënë, emblemat që i kena mbajt na ushtria që janë kanë të veshun.

PY. Dhe kjo ishte emblema që pe tek burrat që ishin veshë me rroba të zeza që morën të afërmin tuaj, kështu?

PË. Po.

PY. Përmendët, ju tha “ne” kishim ato emblema. Për ke e ke fjalën kur the “ne”?

PË. Ushtarët që ishin të veshun, domethënë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta ndërpresim. Mbaroj koha për sot. Mbaruat me këtë linjë pyetjesh?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kam dhe dy pyetje që mund t’i mbaroj shumë shpejt.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbarojini dhe ato shpejt.

ZNJ. MAYER: [Përkthim]

PY. Ku, në ç’vend të rrobave vendosej kjo emblemë? Ku mbaheshin këto emblema?

PË. Kjo mbahej në krah.

PY. Sa afër këtyre burrave ishe kur e pe këtë emblemë? Në ç'distancë e pe, pra, këtë emblemë?
PË. 3 metra 4.
PY. Faleminderit.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Tani është momenti për ta mbyllur për sot.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Dëshmitar, seanca për sot mbaron. Ju do të rifilloni nesër në orën 9.00 të mëngjesit. Faleminderit. Asistentja e sallës së gjyqit do ju shoqërojë jashtë.

Dhe të kalojmë në seancë publike.

DËSHMITARI: Faleminders.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të lejoni të bëj një kërkesë me gojë për një urdhër për Trupin Gjykues, Prokuroria të rishikojë argumentin që ka dorëzuar sa u takon fakteve të gjykuara dhe të bëjë me dije për cilat fakte të gjykuara kërkon të mbështet që të jemi dhe ne në pozitë t'u përgjigjemi. Sepse ça ndodhi me dëshmitarin e fundit na detyron ne që të kërkojmë sqarim të kuptojmë çfarë pozicioni ka Prokuroria sa i takon të gjithë listës së fakteve të gjykuara. Nuk mund të vazhdojmë kështu që Prokuroria ta ndryshojë pozicionin e vet si t'i leverdisë sa u takon fakteve të gjykuara dhe të vërtetësisë.

Pra, do t'ju luteshim që Prokuroria të rishikonte më së paku ato fakte të gjykuara që lidhen me dy personat në fjalë, dy personat me dy viktimat të cilat kanë dhe emrin dhe të na thonë cili është qëndrimi i tyre aktual. Sepse është e paqartë pozicioni i tyre dhe duhet marrë një vendim nga Trupi Gjykues sepse qëndrimi që kanë paraqitur fillimisht është i ndryshëm nga qëndrimi që po paraqesin aktualisht.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim parasysh dhe do dalim me vendim.

Meqë jemi në seancë publike, do të jap edhe vendimin sa u takon provave materiale 2D6 dhe 2D7 që ishin shënuar për identifikim më herët.

U dorëzuan nga Mbrojtja e Veselit.

Fillimisht flas për provën materiale 2d6, që është kartela mjekësore dhe një fragment përkatës nga dokumenti gjyqësor i Sabit Gecit dhe të tjerë, i gjyqit të Sabit Gecit dhe të tjerët. Në shqip është SITF0018880 dhe SITF00370180. Në anglisht SITF0018867 si dhe SITF00370160 deri në SITF00370161.

Trupi Gjykues është pranuar të pranojë faqen e parë, që është versioni shqip SITF0018880 dhe në versionin anglisht është faqja që u tha pak më herët.

Këtu duam të garantojmë që kjo pjesë e pyetjeve të jetë e plotë dhe kuptueshme tërësisht. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 40(6)(h) të Ligjit dhe rregullës 138(1) të Rregullores, faqja e parë e provës materiale 2D6 si në shqip dhe në

anglisht, pranohet.

Sidoqoftë, pjesa e dytë e 2D6, në të vërtetë një deklaratë që është dorëzuar për vërtetësinë e përmbajtjes. Si e tillë është objekt i rregullës 153 deri në 155. Nëse Mbrojtja dëshiron ta paraqesë duhet ta bëjë këtë në përputhje me këto rregulla që sapo përmenda. Pjesët e mbetura të dëshmisë të doktorit që ka trajtuar z. Geci janë vendosur në transkript dhe janë komentuar nga dëshmitari. Nuk ka asnjë vlerë që të shtojmë edhe deklaratën edhe dokumentacionin gjyqësor dhe kjo nuk shkakton asnjë dëm Mbrojtjes.

Faqet e mbetura të materialit numër 2D6 dhe 2D6-ET, nuk pranohen.

Sa i takon provës materiale 2D7, përkatësisht SITF00299827 deri në SITF00299830 që është një paketë, një pjesë, pra, e SITF00299825-00299851 1RED, që është një deklaratë e dëshmitarit e dhënë UNMIK-ut nga Shaban Krasniqi, Trupi Gjykues nuk është i përgatitur ta pranojë këtë deklaratë.

Deklarata ofrohet për vërtetësinë e përmbajtjes e për rrjedhojë është objekt i rregullës 153, 155. Nëse Mbrojtja dëshiron ta paraqesë duhet ta bëjë në përputhje me këto rregulla.

Në këtë moment në kohë, Trupi Gjykues nuk e pranon provën materiale 2D7.

Me këtë mbyllim dhe seancën për sot. Do të shihemi nesër

në orën 9.00. Faleminderit për vëmendjen. Seanca ndërpritet.

--- Seanca mbyllet në orën 16.07